




40 HADITHE

mbi personalitetin Islam



ALI HASEN EL-HALEBIU

Dyzet hadithe mbi personalitetin Islam

Ali Hasan Ali Abdul-Hamid
el-Halebi

Përmbajtja

Prezantim i autorit.....	5
- Dëlirësia dhe singjeriteti i qëllimit -.....	9
- Dallueshmëria -	10
- Drejtësia dhe të qenit i balancuar (mesatar) -	11
- Luftë kundër dëshirave personale -	12
- Butësia -	13
- Kthimin në të vërtetën -	13
- Përgjegjësinë -	14
- Muslimani mundohet që t'i arsyetojë muslimanët tjerë -.....	15
- Muslimani nuk e ushqen zemrën e tij me inat -	16
- Pasimin dhe zbatimin e udhëzimit hyjnor -	17
- Muslimani nuk ka kohë të lirë -	18
- Devotshmëria e muslimanit dhe vetëpërmbajtja -.....	18
- Muslimani është i ndershëm dhe i singjertë në të gjitha çështjet e tija -	20
- Dituri për dituri -	21
- Besimtari është pasqyrë për vëllain e tij -	22
- Luftën e muslimanit dhe djallit të tij -	22
- Përkujtimi i Allahut -	24
- Muslimani nuk përgojon -	25
- Muslimani nuk është kureshtar për gjërat që nuk janë në interes të tij -	27

- Të gjitha veprat e tija janë për Allahun -	27
- Muslimani pendohet dhe i kthehet Allahut -	28
- Karakteristikat esenciale të personalitetit të tij -	29
- Të tallurit e ndershëm -	29
- Kohë për këtë dhe kohë për atë -	30
- ai nuk i konsideron mëkatet me mendjelehtësi -	31
- Muslimani nuk është mizor -	32
- Ai nuk është bartës i thënieve keqdashëse -	33
- Ai nuk është i përkushtuar ndaj kësaj bote -	34
- Distançimi nga kjo botë -	35
- Veprat e mira -	36
- Muslimani është i kënaqur -	36
- Devotshmërinë në fenë Islame -	37
- Si ballafaqohet muslimani me njerëz -	38
- Vizita vëllait -	38
- Karakteri i muslimanit -	39
- Muslimani e di vlerën e vet -	39
- Ai shpreson për të mirën e vetvetes dhe vëllait të tij -	40
- Urdhërimin në të mirë dhe ndalimit nga e keqja -	40
- Të qenit i kujdesshëm që t'i shmanget armiqësisë dhe përçarjes -	41
- Mënyrat për t'u ikur sprovave të cilat i godasin njerëzit -	42
Epilog	43

Fundota: 45

Prezantim i autorit

I gjithë lavdërimi dhe falënderimi i takon Allahut. Ne e lavdërojmë Atë dhe i shprehim falënderimin. Kërkojmë ndihmën dhe faljen e Tij, dhe kërkojmë strehim te Allahu nga e keqja e vetes sonë dhe nga veprat tona të këqija. Atë që Allahu e udhëzon askush s'mund ta humbë, dhe atë që Ai e humb askush s'mund ta udhëzojë. Dëshmoj se askush s'ka të drejtë të adhurohet përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak, dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij – më tej:

Ky është një libër konciz i cili përmban dyzet hadithe autentike⁽¹⁾ nga thëniet e bukura të Pejgamberit të Zgjedhur (sallallahu 'alejhi ue selam) të cilat i përmbledha si përkujtues për veten time dhe vëllezërit e mi. Ato përmbajnë udhëzim për kultivimin e shpirtit, pastrimin e zemrave dhe formësimin e karakterit. Unë vetë nuk kam shtuar asgjë përveç disa fjalëve për të sqaruar dhe shpjeguar çfarëdo të paqartë, që të paraqes titujt e kapitujve që tregojnë lidhjen në mes të haditheve, dhe shënimeve të shkurtëra të mëtutjeshme.

Nuk do të jetë e panjohur për asnjë njeri se Dini fisnik i Islamit i ka dhënë rëndësi të madhe dhe i ka kushtuar vëmendje të plotë në shumë tekste të Librit dhe Sunetit personalitetit të Muslimanit, duke e udhëhequr atë në përputhje me mësimet esenciale të Islamit dhe fundamenteve e kërkesave të tij.

Motivi kryesor që më shpiu në kompilimin dhe përmbledhjen e këtij punimi ishte kur pashë se shumë prej atyre që pasojnë Islamit dhe thërrasin në Allahun, në të vërtetë janë larg të zhvendosur nga personaliteti Islamik në esencë, sjellje dhe në paraqitjen e jashtme. Kërkojmë prej Allahut që të na mbrojë dhe të na dhurojë siguri. Meqë kështu qëndron puna, mendova se është më se nevojshme të përmblodhi këtë ese që të mund të jetë nukleus i qëndrueshëm dhe i fortë për muslimanin, që ta iniciojë jetën e tij Islamike, ta njeh rrugën e vërtetë, ta ndjek atë, dhe të thërret në të. Posaçërisht pasi që Pejgamberi (sallallahu 'alejhi ue selam) ka treguar në këtë realitet me thënien e tij: për çdo vepër është një periudhë e entuziazmit/aktivitetit, dhe për çdo periudhë të entuziazmit/aktivitetit është një periudhë e pushimit/inaktivitetit. Kështu që ai, periudha e pushimit/inaktivitetit i të cilit është në përputhje me Sunnetin tim, atëherë ai është i udhëzuar drejt; por atij të cilit periudha e pushimit/inaktivitetit i përputhet me tjetër përveç kësaj, ai është i shkatërruar(2).

Pra, e shkrova këtë libër për rininë entuziaste muslimane e cila nuk gjen, derisa noton në oqeanin e entuziazmit dhe ngazëllimit, ndihmën e atij që e njeh helmin dhe është i vetëdijshëm për shërimin, atij që mund ta udhëzojë në rrugën e drejtë dhe të menduarit e shëndoshë ashtu që kjo rini të jetë me mendje dhe mendime si të Shoqëruesve të Pejgamberit (sallallahu 'alejhi ue selam) meqë edhe ata po ashtu kanë qenë rini, por: Ata ishin rini, megjithatë rini e pjekur, sytë e tyre të freskët dhe të pastër nga e keqja, këmbët e tyre të përmbajtura nga të afruarit ndaj të

pavërtetës dhe kotësisë. Ata e flijuan dhe shpenzuan veten e tyre në adhurim dhe u përmbajtën nga të fjeturit. Ata i shitën shpirtrat e tyre të përkohshëm për shpirtra që kurrë s'do të vdesin. Allahu i pa ata në pjesët e vona të natës duke i përkulur shpinat e tyre dhe duke kënduar Kur'an. Sa herë që ndonjëri prej tyre vinte deri te ndonjë ajet ku përmendej Parajsa, ai qante duke e dëshiruar atë. Toka i përpiu gjunjët e tyre, duart e tyre dhe ballët e tyre. Ata e bashkuan rraskapitjen në natë me rraskapitjen në ditë. Ngjyra e tyre bëhej e verdhë dhe trupat e tyre dobësoheshin nga të qëndruarit e gjatë në namaz dhe agjërimin të shpeshtë – derisa i konsideronin veprat e tyre si të pavlefshme para Allahut. Ata e përmbushën marrëveshjen me Allahun dhe e arritën premtimin e Allahut(3). Pra, të ngutemi edhe ne të bëhemi sikur ata dhe t'u ngjasojmë atyre meqë çështja qëndron ashtu siç është thënë: Ne nuk jemi ndryshe në krahasim me ata që erdhën para nesh, përveç sikur herba (bimë) e vogël që rritet pranë trungut të një druri të gjatë pallme(4). Dhe siç ka thënë Ibn ul Mubarek: Mos na përmendni neve derisa i përmendni ata, se i shëndoshi dhe i shkathti kur ecë nuk është sikur i gjymti(5).

Jam munduar që në zgjedhjen e këtyre haditheve t'i mbledhi ato të cilat janë më përfshirëse, por personaliteti Islamik nuk do të kompletohet derisa individit të pasojë dhe zbatojë fenë (Dinin) e Allahut i Cili është i pastër nga çdo e metë, dhe i Lartësuarit thotë:

“O ju që besoni! Hyni në Islam me tërë qenien.”(6)

Jam përpjekur që të përmend burimin e çdo hadithi së bashku me një deklaratë në lidhje me autenticitetin e tij, ashtu siç kërkohet nga shkenca e hadithit, derisa u jam shmangur zgjatjeve të panevojshme apo lënies mangët të diçkaje të domosdoshme; dhe jam munduar të jem i prerë aq sa është e përshtatshme për një libër të këtij vëllimi, dhe vetëm rrallëherë e kam zgjatur aty ku kemi të bëjmë me atë që është esenciale.

Pra, nëse Allahu më udhëzon dhe më dhuron atë që është korrekte në atë çka kam për qëllim, atëherë kjo është prej plotësimit të bekimeve të Tij, por nëse rezultati del ndryshe, dhe shpresojë se ky nuk është rasti, atëherë lus Allahun për faljen e Tij dhe mëshirën e Tij. Vërtet, Ai është që dëgjon dhe përgjigjet, dhe thirrja jonë e fundit është se i gjithë lavdërimi the falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

‘Ali Hasan ‘Ali-Hamid al-Halebi el-Etheri 11 Rexheb, 1408H,
el-Zerka (Jordan)
28 Shkurt, 1988

- Dëlirësia dhe sinqeriteti i qëllimit -

Prej 'Umer ibn el-Khatab (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ue selam) ka thënë:

"Veprat varen prej qëllimit dhe çdo personi i takon vetëm ajo për çka e ka pasur qëllimin. Kështu që ai, migrimi i të cilit ishte për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, atëherë migrimi i tij ishte për Allahun dhe të Dërguarin e tij; ndërsa ai, migrimi i të cilit ishte për arritjen e ndonjë qëllimi të kësaj bote apo që të martohet, atëherë migrimi i tij ishte për atë për çka ka migruar."(7)

Shtylla e veprave është qëllimi i dëlirë dhe i sinqertë, dhe përmes dëlirësisë së qëllimit zemrat drejtohen e qetësohen, dhe përmes kësaj individi vjen deri te njohja e rrugës së drejtë në fenë e tij, kështu që ai çdo gjë e bën në mënyrë korrekte. Vetëm përmes dëlirësisë së qëllimit ai do t'i njohë detyrimet që i ngarkohen dhe të drejtat që i takojnë atij. Përmes kësaj ai do të sillet me drejtësi në të gjitha çështjet dhe çdo gjëje do t'ia japë të drejtën që i takon, jo duke i tejkaluar kufijtë e as duke lënë diçka mangut.

Pra, ky hadith është një prej haditheve të cilat janë shtyllat e të kuptuarit të saktë të fesë tonë të vërtetë dhe të drejtë.(8)

Kur robi musliman e kupton qartë atë që parapriu, atëherë atij i bëhet e detyrueshme, pa kurrfarë ngurrimi, ta rrethojë qëllimin e tij të sinqertë me një barrierë mbrojtëse për personalitetin Islamik e cila është:

- Dallueshmëria -

Prej Ibn 'Umerit (radiallahu 'anhû) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Jam dërguar para Çastit që vetëm Allahu të adhurohet pa i shoqëruar Atij ortak, dhe se furnizimi im më është vendosur nën hijen e shtizës sime, ndërsa përulja e poshtërimit është vendosur mbi ata të cilët i kundërshtojnë urdhrat e mi, dhe kushdo që e imiton një popull, ai është njëri prej tyre"(9)

Muslimani ka një personalitet të dalluar me natyrën e vet të veçantë dhe sjelljen e botëkuptimit e posaçëm. Ai është i dallueshëm në paraqitjen e tij, natyrën e tij, besimin ('akiden) e tij, orientimin dhe kahen e kthyer në namaz, dhe në të gjitha çështjet e tija.

Duke qenë të dalluar si muslimanë, ne e ruajmë Islamin dhe thirrjen tonë në një formë të qartë dhe të dëlirë, të pastër nga çdo falsifikim dhe gabim.

Sidoqoftë, muslimani derisa është i dallueshëm nuk largohet nga:

- Drejtësia dhe të qenit i balancuar (mesatar) -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Dojeni atë që e doni deri në një shkallë të caktuar (me maturi), ndoshta një ditë ai do të jetë dikush ndaj të cilit keni urrejtje, dhe urrejeni atë ndaj të cilit keni urrejtje deri në një shkallë të caktuar, ndoshta një ditë ky do të jetë ai të cilin e doni."(10)

Muslimani është i balancuar në dashurinë dhe urrejtjen e tij. Ai është i drejtë kur jep dhe kur merr, dhe është i matur në tërë këtë. Të qenit e tij i balancuar është një prej shenjave të fesë dhe Sheriatit të tij. Kështu që ai nuk është i atillë që kalon kufijtë e as i atillë që të dështojë në atë çka kërkohet prej tij. Përveç kësaj, muslimani nuk e nxjerr këtë kualitet i të qenit i balancuar prej intelektit dhe dëshirave e as nga mendimi i tij apo nga diçka tjetër përveç kësaj, më saktë, ai këtë e merr nga Libri i Allahut, i Cili është i pastër nga çdo e metë.

"Ne u bëmë juve një popull mesatar, që të jeni dëshmitarë ndaj njerëzimit dhe i Dërguari (Muhamedi sallallahu 'alejhi ue selam) të jetë dëshmitar ndaj jush."(11)

Të qenit i balancuar nuk është një çështje e lehtë, vërtet, shumë prej atyre të cilët deklarohen dhe thërrasin në të, dëshirojnë që vetëm ta qetësojnë situatën dhe të bëjnë kompromis. Pra, që një individ të jetë i balancuar siç

urdhërohet nga Allahu nuk është, siç kam thënë, lehtë, por më saktë, kjo kërkon:

- Luftë kundër dëshirave personale -

Prej el-'Ala ibn Zijadit i cili tha:

Një njeri e pyeti Abdullah ibn Amr ibn el'Asin, duke thënë: "Cili prej besimtarëve është më i miri në Islamin e tij?" Ai u përgjigj: "Ai, prej gjuhës dhe dorës së të cilit muslimanët janë të sigurt." Ai pyeti: "Atëherë cili prej atyre që migrojnë (bëjnë hixhret) është më i miri?" Ai u përgjigj: "Ai i cili lufton kundër egos dhe dëshirës së tij për hir të Allahut." Ai pyeti: "A është kjo diçka që ti ke thënë, O Abdullah ibn 'Amr, apo i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) e ka thënë këtë?" Ai tha: "I Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) e ka thënë këtë."(12)

Pra, të luftosh kundër egos është njëra prej mënyrave më të larta dhe më të çmueshme për rritjen e imanit dhe afrimin e robit më afër Zotit të tij, i Cili është i pastër nga çdo e metë. Në lidhje me këtë Ai, i Bekuari dhe më i Larti, thotë:

“Sa u përket atyre që përpiqen në Neve (Qëllimin Tonë), Ne me siguri do t'i udhëzojmë në Rugët Tona (d.m.th. në fenë e Allahut)”(13)

Pra, muslimani duke luftuar kundër egos dhe dëshirave të tij e ngritë moralin më lart, e rritë imanin e tij dhe e pastron

shpirtin. Përveç kësaj, kjo përpjekje e kurorëzon muslimanin me një kurorë madhështore në jetën e tij, që është:

- Butësia -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Vërtet, Allahu është i butë dhe e do butësinë, dhe ka bërë që me butësi të arrihet ajo që s'mund të arrihet me ashpërsi."(14)

Përmes butësisë zemrat bashkohen në miqësi dhe dashuri, dhe e mira përhapet. Përderisa përmes të kundërtës së saj mbizotërojnë ndjenjat e këqija dhe dyshimi, dhe njerëzit largohen prej njëri-tjetrit. Por butësia e lehtëson:

- Kthimin në të vërtetën -

Prej Ibn 'Abasit (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Nuk ka rob besimtar përveç se të ketë një mëkat të cilin e bën herë pas here, apo një mëkat në të cilin ngulmon dhe nuk e lë atë derisa ta lëshojë këtë botë. Vërtet, Besimtari është krijuar si një i cili vazhdimisht sprovohet, i cili shpesh pendohet (pastaj) harron. Kur ai këshillohet, e pranon këshillën."(15)

Kështu që thuhet se: Kthimi në të vërtetën është virtyt, ndërsa të vazhduarit në të pavërtetën është e përbuzur. Kthimi në të vërtetën e lartëson individin dhe ia ngritë gradën, si te Allahu ashtu edhe tek njerëzit. Vërtet, Shejtani është ai që ua bën njerëzve të duket se kthimi në të vërtetën është një e metë dhe mospërfillje e nderit të njeriut. Kjo është një prej mashtrimeve dhe trukeve që i përdorë Iblisi. Individit i cili kthehet në të vërtetën, duke mos qenë tepër krenar që mos ta pranojë atë, vendoset në një pozitë ideale që ta çmojë:

- Përgjegjësinë -

Prej 'Umerit (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Secili prej jush është kujdestar dhe përgjegjës për ata mbi të cilët ka pushtet. Kështu që sundimtari është kujdestar dhe përgjegjës për të nënshtruarit e tij; Burri është kujdestar i familjes së tij dhe përgjegjës për ata që janë nën kujdesin e tij; Gruaja është kujdestare për shtëpinë e burrit të saj dhe është përgjegjëse për ata që janë nën kujdesin e saj; robi është kujdestar i pasurisë së zotëriut të tij dhe është përgjegjës për atë që i është besuar; dhe njeriu është kujdestar i pasurisë së babait të tij dhe është përgjegjës për atë që është nën kujdesin e tij. Pra, secili nga ju është kujdestar dhe përgjegjës për atë çka i është besuar atij."(16)

Pra, sikur secili nga ky Umet ta dinte pozitën dhe vlerën e vet, dhe ta realizonte përgjegjësinë që i është ngarkuar dhe të mos kërkonte ta kalojë atë e të merr përgjegjësitë e të tjerëve, dhe të zbatonte detyrimet të cilat i janë ngarkuar, atëherë kjo do të ishte një e mirë përfshirëse e universale dhe një thesar i madh përmes të cilit do të vendoseshin siguria dhe rehatia. Krahës kësaj, diçka që është një veçori e personalitetit Islamik është se:

- Muslimani mundohet që t'i arsyetojë muslimanët tjerë -

Prej Sa'd ibn 'Ubades (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

...dhe askush nuk ka dëshirë më shumë se Allahu që të pranojë një arsyetim, dhe për shkak të kësaj ai dërgoi prurësit e lajmeve të mira dhe paralajmëruesit...(17)

Kështu që një musliman i cili mundohet ta arsyetojë vëllain e tij dhe ata të cilët i do, do të përhapë vullnetin e mirë në vend të antagonizmeve, dhe do të vendosë lidhje miqësore në vend të përçarjes. Meqë Allahu, i Cili është i pastër nga çdo e metë, jep arsye, dhe Ai është Krijuesi dhe më Madhështori, atëherë si mundesh ti, O rob i Allahut, një krijesë e dobët e Tij, të mos mundohesh t'i arsyetosh të tjerët? Por më saktë, siç është thënë: Mundohu të gjesh arsye për vëllain tënd.(18) E ngjashme me këtë është thënia: Besimtarët mundohen të gjejnë arsye për të

tjerët, derisa hipokritët shpresojnë në rënien e të tjerëve. Kështu që fakti se muslimani mundohet të gjejë arsytim për vëllezërit e tij e thekson atë se:

- Muslimani nuk e ushqen zemrën e tij me inat -

Prej Ibn Mes'udit (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut ka thënë:

"Nuk bën të ketë inat përveç në dy raste(19): Njeriut të cilit Allahu i ka dhënë pasuri të cilën e shpenzon në mënyrë të duhur, dhe njeriut të cilit Allahu i ka dhënë Urtësi (d.m.th. Kur'anin) dhe vepron sipas saj dhe ua mëson atë të tjerëve."(20)

Sikur të kishte inat ndaj njerëzve, ai do të shpresonte në rënien e tyre me qëllim që të kënaq krenarinë që e ka në veten e tij, si dhe kotësinë e fudullëkun e mendjes së tij. Pra, ai (Muslimani) e di se inati është një sëmundje e vështirë dhe një e keqe dëmtuese dhe për këtë largohet nga ai (inati).

Sa i përket inatit, i cili është i pranueshëm nga ajo çka është mëkat, atëherë ky është inat i cili nuk e bën individin që të vuan prej sëmundjes së të dëshiruarit që bekimi të largohet prej një individi. Më saktë, ai i lutet Zotit të tij, i Cili është i pastër nga të gjitha të metat, për vëllain e tij, që Allahu ta mbrojë atë, dhe për vetveten; dhe që Allahu ta bëjë atë, që ta do atë. Sa i përket asaj që s'është në përputhje me këtë, atëherë ajo është e dënuar.(21) Pra, kjo vë në pah faktin se muslimani është ai i cili bën:

- Pasimin dhe zbatimin e udhëzimit hyjnor -

Prej Um ud-Derdas (radiallahu 'anha) e cila tha: I thashë Ebu Derdas (radiallahu 'anhu): "A nuk do të kërkosh gjëra që të argëtosh mysafirët ashtu siç kërkojnë të tjerët gjëra për argëtimin e mysafirëve të tyre?" Ai u përgjigj: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) duke thënë:

"Përballë jush është një mal i thukët, i cili nuk do të kapërcehet nga ata të cilët janë të mbingarkuar." Kështu që unë dëshiroj ta lehtësoj ngarkesën time për atë hipje!"(22)

Pra, muslimani ndjek dhe zbaton udhëzimin hyjnor në të gjitha çështjet e tija. Kjo botë për të është thjesht një kalim për në Jetën Tjetër dhe nuk është i dhënë pas saj, përveç asaj e cila është esenciale më qëllim që t'i përmbush nevojat e tija dhe ta ruaj veten.

Por, sa i përket asaj që kjo botë të jetë preokupimi më i madh, dhe të jetë objektivi që synon ta arrijë, duke menduar se ajo çka është duke bërë është mirë, atëherë kjo nuk është prej karakterit apo karakteristikave të muslimanit. Pra, sa i çuditshëm është rasti i njerëzve të cilët e harxhojnë ajkën e jetës së tyre dhe e shpenzojnë rininë e tyre të zhytur në angazhime të kësaj bote duke menduar se janë duke bërë mirë. Vërtet, kjo është diçka prej Shejtanit, çka ai e ka bërë tërheqëse. Pra, si janë në gjendje njerëzit ta bëjnë këtë kur rasti është se:

- Muslimani nuk ka kohë të lirë -

Prej Ibn 'Abasit (radiallahu 'anhu) i cili tha se i dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Janë dy bekime të cilat shumë njerëz i humbin: shëndeti dhe koha e lirë."(23)

E, si mundet ai që s'ka kohë të lirë të preokupohet me këtë botë? Si mundet ai, koha e të cilit është e mbushur, të përjetojë kohë të lirë?

Vini re, Allahu ju mëshiroftë, se çfarë ka thënë njëri prej dijetarëve në lidhje me njërin nga Imamët. "Isha fqinj i tij në shkollën e Kairos, dhe shtëpia ime ishte sipër shtëpisë së tij. Për dymbëdhjetë vite, nuk jam zgjuar në asnjë natë, në cilëndo orë të natës, e të mos e kem vërejtur dritën e qiririt në shtëpinë e tij derisa ai ishte i angazhuar në mësim. Madje, edhe derisa ishte duke ngrënë, librat e tija ishin me të dhe ai ishte i preokupuar me to."(24) Prej atyre gjërave mbi të cilat ndërtohet personaliteti i Muslimanit është:

- Devotshmëria e muslimanit dhe vetëpërmbytja -

Prej en-Nu'man ibn Beshirit (radiallahu 'anhu) i cili tha se e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) duke thënë:

"Ajo çka është e lejuar është e qartë, dhe ajo çka është e ndaluar është e qartë. Në mes të këtyre janë çështjet e dyshimta për të cilat shumica e njerëzve nuk kanë njohuri.

Kushdo që u shmanget çështjeve të dyshimta, e ruan fenë dhe nderin e tij, ndërsa kushdo që bie në çështje të dyshimta, bie në atë që është e ndaluar. Ashtu sikurse një bari i cili i kullotë delet e tija afër kullosës private (të tjetërkujt), ai pa vonuar do të humbë në të. Vërtet, për çdo mbret ka një rezervat privat. Rezervati i Allahut janë ato gjëra të cilat Ai i ka ndaluar. Në trup është një copë mishi, e cila nëse është e mirë, atëherë i tërë trupi është i mirë, por nëse është e prishur, atëherë i tërë trupi është i prishur. Vërtet, kjo copë është Zemra."(25)

Pra, muslimani në lidhje me çfarëdo situatë që mund të përballet në jetën e tij do të duhet të ballafaqohet me secilën prej tyre me njërën nga tri pozitat vijuese:

1. T'i shmanget plotësisht asaj: Kjo ka të bëjë me atë çka është e dyshimtë
2. Ta pranojë atë pa detyrim: Kjo ka të bëjë me atë që është qartë e lejuar
3. Të përmbahet nga ajo: Kjo ka të bëjë me gjërat të cilat s'janë plotësisht të lejuara dhe qartë të ndaluara.

Nëse pozita e fundit tregon diçka, ajo është një indikacion i devotshmërisë së muslimanit dhe frikës nga rënia në atë që është e ndaluar dhe nga hyrja në diçka të keqe.

Prandaj, muslimani përmbahet nga ajo dhe distancohet nga

ajo me qëllim që të kënaq Allahun, dhe të sigurojë se urdhrat e Tij respektohen. Nuk duhet të thuhet ashtu siç thonë disa njerëz: "Kjo s'është e ndaluar, pra bëje atë. Jo, meqë nuk është e lejuar të bëhet çdo gjë tjetër përveç asaj që është ndaluar. Pra, ato gjëra të cilat janë çështje të dyshimta janë më afër asaj që është e ndaluar, siç na paraqitet në vetë hadithin: **"Kushdo që bie në çështje të dyshimta, bie në atë që është e ndaluar."** Pra, kjo frikë dhe devotshmëri konfirmojnë se:

- Muslimani është i ndershëm dhe i singertë në të gjitha çështjet e tija -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Tri gjëra e dallojnë hipokritin: kur ai flet, e thotë të pavërtetën; kur premt, e then atë, dhe kur i besohet, ai dëshmohet të jetë mashtrues."(26)

Kështu që ai është i singertë kur flet, besnik ndaj premtimit të tij, i besueshëm në përmbushjen e asaj çka i është lënë në dorëzim. Ai nuk mashtron apo gënjen, dhe nuk është hipokrit. Pra, besnikëria dhe ndershmëria janë njëra nga cilësitë më të mira, ndërsa gënjeshtria është koka e çoroditjes dhe e së keqes. Nderi i tij e mban atë larg prej së keqes, veprave të ndyta dhe sëmundjes së zemrës. Prandaj, çfarëdo veprë që ai bën, e bën për Allahun, i Cili është i pastër nga çdo e metë, e jo për atë që të arrijë ndonjë pozitë në këtë botë, famë apo reputacion. Kështu që motoja e tij është:

- Dituri për dituri -

Prej Xhabirit (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Mos e mësoni diturinë me qëllim që të garoni me dijetarë, as të polemizoni me injorantin, e as të mbizotëroni në vendtubime. Meqë kushdo që e bën këtë, atëherë: Zjarri! Zjarri!" (27)

Shqyrtojeni, Allahu ju mëshiroftë, këshillën dhe leksionin që përmban ajo çka Ibn Hatim er-Razi tregon, ai tha: "Hyra në Damask tek studentët e hadithit dhe kalova pranë qarkut (vendtubimit) të Kasim el-Xhu'it. E gjeta një grup të ulur rreth tij e ai fliste. Paraqitja e tyre më mahniti, dhe e dëgjova atë duke thënë: "Grabitni dobinë e pesë gjërave nga bashkëkohësit tuaj: kur jeni të pranishëm, jeni të panjohur; kur mungoni nuk vërehet mungesa juaj; kur paraqiteni, këshilla juaj nuk kërkohet; kur thoni diçka, thënia juaj nuk pranohet; dhe kur posedoni dituri, nuk u jepet gjë për të. Po ashtu ju këshilloj në pesë gjëra: kur trajtoheni me padrejtësi, mos u sillni me padrejtësi; kur ju lavdërojnë, mos u gëzoni; kur kritikoheni, mos u shqetësoni; kur nuk ju besojnë mos u hidhëroni; dhe nëse ju mashtrojnë, mos i mashtroni ju ata." Ibn Ebi Hatim tha: "Kështu që e mora këtë si dobi nga Damasku."

Shikoni, Allahu ju mëshiroftë, sesi dëshira e sinqertë për dituri dhe dobi e çoi atë që ta dëgjojë atë i cili sigurisht posedonte më pak dituri se vetë ai, me qëllim që të ketë dobi

prej të kuptuarit e tij dhe të mësojë pak dituri. Një çështje tjetër që duhet të përmendet këtu është ajo se:

- Besimtari është pasqyrë për vëllain e tij -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Besimtari është pasqyrë për besimtarin, dhe besimtari është vëlla për besimtarin. Ai e ruan pronën e tij për të dhe e mbron atë nga prapa."(28)

Përshkrimi i tij si një 'pasqyrë' është mjaft preciz dhe kuptimthellë, që tregon kulminacionin e vëllazërisë dhe solidaritetit. Pra, vëllai yt, O rob i Allahut, është një shëmbëllim i vetës tënde. Nëse ai sillet keq, kjo është sikurse ti të jesh ai që është sillur keq, dhe nëse ai bën një gabim, është sikurse ta bësh ti atë gabim. Pra, ai është pasqyrë për ty, pastaj një shëmbëllim i vetes tënde! Kështu që mos u sillni me të ndryshe, përveç me butësi dhe kujdes. Nëse nuk silleni me vëllain tuaj në këtë mënyrë, atëherë kjo do të jetë diçka që e dobëson:

- Luftën e muslimanit dhe djallit të tij -

Prej Ijad ibn Himar al Muxhashi'it (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Vërtetë Zoti im më ka urdhëruar që t'ju mësojë atë për të cilën nuk keni njohuri. Prej asaj çka Ai më mësoi sot, (duke më udhëzuar): "Pasuria të cilën ia dhuroj një robi është krejtësisht e lejuar për të, dhe Unë i kam krijuar të gjithë robërit e Mi të pajisur me prire natyrore ndaj rrugës së vërtetë, por djajtë u erdhën atyre dhe i shmangën prej fesë (të vërtetë) dhe ua ndaluan atë të cilën Unë ua kam bërë të lejuar, dhe i urdhëruan që të shoqërojnë në adhurimin ndaj Meje atë, për të cilën nuk kam zbritur kurrfarë autoriteti. "Allahu shikoi në njerëzit e tokës dhe i urreu ata, Arabët dhe jo- Arabët, përveç një pjese të mbetur prej Njerëzve të Librit, dhe Ai tha: "Unë të dërgova vetëm që të sprovtoj ty dhe t'i sprovtoj të tjerët përmes teje, dhe ua kam zbritur Librin i cili s'mund të rrëmbehet nga uji, të cilin ju do ta ruani (mbani në mend) dhe ta këndonit derisa jeni të fjetur dhe derisa jeni të zgjuar." Allahu më urdhëroi që t'i shkatërrojë Kurejshitët andaj unë i thashë: "O Zoti im, ata do të ma thyejnë kokën ashtu siç thyhet buka." Ai tha: "Dëboni ju ata ashtu siç ata u dëbuan juve dhe luftoji ata dhe Ne do të të ndihmojmë, dhe shpenzo se Ne do të të furnizojmë. Dërgo një ushtri dhe Ne do të dërgojmë pesë të tjera sikur ajo. Luftoji ata që nuk të binden.

Njerëzit e Parajsës janë tre: Sunduesi i cili është i drejtë, i cili shpenzon në bamirësi dhe është i udhëzuar të bëjë mirë; njeriu i cili është i mëshirshëm dhe zemër-butë ndaj çdo muslimani dhe të afërmi; dhe i dëliri i cili nuk lyp përkundër asaj që ka familje të cilën duhet ta mbajë. Njerëzit e zjarrit janë katër: I dobëti i cili nuk ka vullnet që t'i shmangët të keqes, ata nga mesi juaj të cilët thjesht janë pasues (të tjerëve), ata nuk kujdesen për familje apo pasuri;

dhe i pandershmi, lakmia e të cilit s'mund të fshihet as në rastet e gjërave të vogla; dhe njeriu i cili do të të tradhtojë mëngjes e mbrëmje në lidhje me familjen dhe pasurinë tënde (Ai po ashtu përmendi koprracinë apo të gënjyerit) si dhe personi me sjellje të keqe dhe të folur të ndytë."(29)

Pra, ky është një konflikt mjaft i lashtë, duke filluar prej kohës kur Allahu, i Cili është i pastër nga të gjitha të metat, e krijoi Ademin, 'alejhis-selam, dhe çka ndodhi në mes tij e Shejtanit është mirë e njohur. Ky konflikt do të intensifikohet apo dobësohet varësisht nga afërsia apo largimi nga Zoti i tij. Shqyrtojeni po ashtu këtë thënie të tij (sallallahu 'alejhi ue selam): **"Shejtani ka humbur çdo shpresë se ata që falin namaz do ta adhurojnë atë, por ai mundohet që të provokojë armiqësi mes tyre."**(30)

Pra, le të jetë kjo një paralajmërim për ne, ndërsa e kundërta e kësaj le të jetë sihariq. Ne s'duhet ta lëmë asnjë rrugë për Shejtanin që të hyjë në zemrat tona përmes veprave tona, duke mos i dhënë atij as qasje të plotë as të pjesshme. Vërtet, mashtrimet dhe kurthet e tija janë të shumta.(29) Kështu që ruaju nga kjo, O rob i Allahut, dhe mos e lë Shejtanin që të të kurthojë me grackat dhe truqet e tija, dhe fortësia e juaj e pathyeshme kundër tij është:

- Përkujtimi i Allahut -

Prej Nu'man ibn Beshir (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut ka thënë:

"Lutja (ed-Du'a) është adhurim, Zoti juaj, i Madhërishmi, ka thënë: "Më thirrni Mua – Unë do t'ju përgjigjem lutjeve tuaja."(32,33)

Lutja është koka e të përkujtuarit të Allahut. Vërtet, ai (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë: "...dhe ju urdhëroj që ta përmendni Allahun shumë. Kjo i përgjigjet shembullit të njeriut i cili duke qenë i ndjekur nga armiku, të cilët nguten për ta zënë atë, arrin në një fortesë të mbrojtur dhe kështu e mbron veten aty. I këtillë është robi, se ai nuk e mbron veten prej Shejtanit përveç përmes përkujtimit të Allahut të Madhërishëm."(34)

Pra, Muslimani duke e përkujtuar Allahun, i Cili është i pastër nga çdo e metë, arrin në një pozitë të sigurisë dhe mbrojtjes, të cilën Shejtani s'mund ta mbizotërojë. Kështu që kjo e parandalon atë prej shumë mëkateve dhe vetive të shumta negative që i përkasin gjuhës, gjymtyrëve dhe zemrës. Prandaj:

- Muslimani nuk përgojon -

Prej Ibn 'Umerit (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Kushdo që ndërmjetëson dhe e parandalon një prej dënimeve të urdhëruara nga Allahu i Madhërishëm, ai e ka kundërshtuar Allahun në lidhje me urdhrat e Tij. Kushdo që vdes duke i pasur borxh dikujt, nuk do t'i kompensohet me

dinarë dhe dirhem, por me vepra të mira dhe të këqija. Kushdo që polemizon për diçka që e di se është e pavërtetë, ai mbetet në hidhërimin e Allahut përderisa të ndalet. Kushdo që e akuzon një besimtar për diçka që s'është e vërtetë, Allahu do ta bëjë atë banor të qelbit që rrjedh nga banorët e Zjarrit, dhe ai nuk do të del prej aty derisa të tërhiqet nga ajo çka ka thënë." (35)

Pra, sëmundja vdekjeprurëse e përgojimit i shkatërron veprat e njeriut, e shkatërron vëllazërinë dhe shkatërron shpërblimin e individit. Muslimani i vërtetë nuk përgojon e as nuk lejon që përgojimi të ndodhë në praninë e tij. Pra, le t'i frikohen Allahut ata njerëz, trupat e të cilëve nuk zhvillohen dhe shpirti i të cilëve nuk ushqehet me tjetër përveç me shpërndarjen e thashethemeve dhe shpikjen e gënjeshtreve kundër robërve të Allahut, duke pohuar se kjo është në dobi të da'ves (thirrjes)!

Sa çudi! Çfarë dobie do të ketë për da'vetin përmes ofendimeve, përgojimeve dhe përmendjes së vetive të këqija të të tjerëve? A mendoni, O ju që përgojoni njerëz, se jeni larg të metave? O ju të cilët i shihni vetëm mangësitë e të tjerëve, a mendoni se jeni të pagabueshëm? Ju jeni përplot mangësi dhe njerëzit kanë gjuhë! Po ashtu prej atyre gjërave që duhet të dihen është se:

- Muslimani nuk është kureshtar për gjërat që nuk janë në interes të tij -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut ka thënë:

"Prej përsosurisë së Islamit të individit, është ajo se ai e lë atë çka nuk është në interes të tij." (36)

Pra, ai ndalet në kufijtë e tij dhe nuk i tejkalon ata. Ai e di se të qenit kureshtar për atë që nuk është në interes të tij dhe të pyeturit për atë, nuk i takon atij. Më saktë, kjo është e ndaluar për të dhe diçka që duhet t'i shmanget. Kështu që ai u përshtatet urdhrave të Allahut dhe largohet nga ajo që Ai ka ndaluar, meqë:

- Të gjitha veprat e tij janë për Allahun -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut ka thënë:

"Kushdo që do për Allahun dhe urren për Allahun, jep për Allahun dhe mban (nuk jep) për Allahun, atëherë ai e ka plotësuar imanin."(37,38) Ky hadith qartë paraqet mënyrën me të cilën besimtari i udhëheq të gjitha çështjet e tij dhe sillet në të gjitha ballafaqimet e tij; të gjitha veprat i ka për Allahun dhe nuk i bën për ndokënd tjetër përveç Tij, i Cili është i pastër nga të gjitha të metat. Në të gjitha çështjet e tij

ai largohet nga përfitimet personale dhe kënaqësitë. Kur do dhe urren, jep dhe mban, ai e kërkon vetëm kënaqësinë e Allahut dhe Parajsën e Tij. Ai nuk kërkon të fitojë pozitë në këtë botë, pasuri apo reputacion! E, nëse bie në këso gjëra, ai pendohet dhe i kthehet Zotit, pra:

- Muslimani pendohet dhe i kthehet Allahut -

Prej Ebu Se'id el-Hudriut (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut ka thënë:

"Shembulli i besimtarit në lidhje me imanin është sikurse shembulli i kalit në raport me hurin lidhës - sillet përreth, pastaj kthehet tek huri lidhës i tij. Edhe besimtari është neglizhent, pastaj i kthehet imanit të tij. Pra, ushqeni të devotshmit me ushqimin tuaj dhe trajtoni mirë besimtarët."(39)

Ai nuk ngulmon në mëkat dhe nuk e trajton atë me mendjelehtësi. Ashtu sikurse edhe fëmijët e tjerë të Ademit alejhi selam, ai bën mjaft mëkate. Mirëpo, ai vazhdimisht i kthehet Zoti të tij me pendim.

Ajo që parapriu na tregon qartë:

- Karakteristikat esenciale të personalitetit të tij -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu alejhi ue selam) ka thënë:

"Nuk gjinden dy karakteristika së bashku në një hipokrit: sjellja e mirë dhe të kuptuarit e fesë."(40)

Pra, sjellja e tij është sjellje e njerëzve të drejtë dhe sjellje e robërve të Zotit të Botëve. Ai matet me të devotshmit dhe ndjek hapat e të singertëve. Zemra dhe sjellja e tij dakordohen. Ai nuk është sikur të dobëtit, të cilët e mundojnë veten e tyre që të bëjnë një paraqitje sa më të mirë derisa zemrat e tyre janë të zbrazëta! Dituria e tij dhe të kuptuarit e fesë është e thellë dhe buron nga një zemër e mirë sensitive dhe kujtesë precize.

Mirëpo, sjellja e mirë, dituria dhe të kuptuarit e fesë nuk e parandalojnë atë prej:

- Të tallurit e ndershëm -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha: Ne thamë: "O i Dërguar i Allahut! Po tallesh me ne?" Ai (sallallahu 'alejhi ue selam) tha:

"Po, por unë nuk flas tjetër përveç asaj çka është e vërtetë."(41)

Kështu që e pavërteta nuk bën pjesë në këtë, dhe gënjeshttrat nuk mund t'i afrohen kësaj. Pra, të tallurit e tij është me fjalë që janë të vërteta. Por kjo nuk do të thotë se ai do ta shpenzojë tërë kohën e tij në shkujdesje dhe tallje. Më saktë, në këtë dhe në të gjitha çështjet tjera, ai ndjek hapat e Sahabëve, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë prej tyre, dhe mënyra e tyre lidhur me këtë çështje ishte:

- Kohë për këtë dhe kohë për atë -

Prej Handhale el-Usejjidit i cili tha: Ebu Bekri më takoi dhe më pyeti: "Si je, O Handhale?" Unë iu përgjigja: "Handhale ka bërë hipokrizi!" Ai tha: "I pastër është Allahu nga çdo e metë! Çfarë je duke thënë?" Unë i thashë: "Kur jemi me të Dërguarin e Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ai na e përkujton Zjarrin dhe Parajsën sikur ta kishim parë më sytë tanë. Pastaj ne ndahemi prej të Dërguarit të Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) dhe preokupohemi me gratë tona, fëmijët dhe tregtinë, dhe shumë nga ajo harrojmë." Ebu Bekri tha: "Pasha Allahun, edhe mua ne ndodh e njëjta gjë." Kështu që shkua me Ebu Bekrin te i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam). Unë thashë: "Handhale ka bërë hipokrizi, O i Dërguar i Allahut." I Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) tha: "Si ashtu?" Unë i thashë: "Kur jemi me ty, ti na e përkujton Zjarrin dhe Parajsën sikur ta kishim parë me sytë tanë. Pastaj kur ndahemi prej teje preokupohemi me gratë tona, fëmijët dhe tregtinë e pastaj shumicën e kësaj e harrojmë." I Dërguari i Allahut tha: "Pasha Atë, në dorën e të cilit është shpirti im, sikur të

mbeteshit vazhdimisht ashtu sikur kur jeni me mua në përkujtimin e Allahut, atëherë engjëjt do t'ju kishin mbajtur për dore në shtratet tuaja dhe në rrugë. Por, O Handhale, (është) një kohë për këtë dhe një kohë për atë, një kohë për këtë dhe një kohë për atë, një kohë për këtë dhe një kohë për atë." (42)

Pra, të dyja këto kohë janë të rregulluara me rregullat e Allahut, ashtu siç parapriu. Koha e tij për çështje serioze është e rregulluar sipas Librit dhe Sunnetit, dhe të tallurit e tij është të pastër nga çfarëdo qoftë e ndaluar dhe është e shoqëruar me atë në çka Allahu ka urdhëruar.

Pra, ai nuk lejon që përmes neglizhencës, të tallurit e tij të bëhet një rrugë në të cilën bie në mëkat. Si do ta bënte këtë kur:

- ai nuk i konsideron mëkatet me mendjelehtësi -

Prej Sehl ibn Sa'dit (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Ruajuni nga mëkatet që trajtohen si të vogla (të parëndësishme), mu ashtu sikurse një popull i cili fushohet (ngre kampin) në mes të një lugine, ashtu që dikush e sjell një shkop për ndezje zjarri dhe tjetri e sjell një shkop tjetër, derisa të jenë në gjendje ta pjekun bukën e tyre. Ngjashëm me këtë, mëkatet të cilat trajtohen si të vogla, dhe për të cilat individit merret në përgjegjësi, do ta shkatërrojnë atë." (43)

Pra, është mu ashtu siç ka thënë Sahabiu (shoqëruesi) bujar ‘Abdullah ibn Mes’ud: "Besimtari i sheh mëkatet e veta sikur të ishte ulur nën një mal nga i cili frikësohet se mund të bie mbi të në çdo moment, derisa i keqi i sheh mëkatet e veta sikurse njeriu i cili e ka një mizë në hundë, kështu që ia bën kështu (njëri prej kumtuesve tha: Ai e fshin atë nga hunda)." (44)

Muslimani duhet ta kuptojë madhështinë e Zoti të tij, i Cili është i pastër nga çdo e metë, dhe Fuqinë e Mundësinë e hatashme të Tij, dhe nuk duhet të mendojë në atë se a është mëkati i madh apo i vogël! Por ai duhet të mendojë për Atë, të Cilin është duke e kundërshtuar. Këto mëkate të cilat injorohen nga ata me zemra të dobëta, shkaktojnë shkatërrimin e tyre duke e zhvendosur imanin dhe frikën ndaj Allahut prej zemrave të tyre. Kur një individ i shpërfille mëkatet dhe aktet e mosbindjes, ai i cili i bën padrejtësi shpirtit të vet, dhe kjo kurrë nuk duhet të ndodhë, meqë:

- Muslimani nuk është mizor -

Prej Xhabir ibn ‘Abdullahut (radiallahu ‘anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu ‘alejhi ue selam) ka thënë:

"Kini kujdes të mos bëni padrejtësi, se në Ditën e Ringjalljes padrejtësia është errësirë. Dhe ruajuni koprracisë, se koprracia i shkatërroi ata që erdhën para jush. Ajo i shpjeu ata deri në derdhjen e gjakut dhe të bërit të lejuar atë çka ishte e ndaluar për ta." (45)

Padrejtësia është dy llojesh: (i) Individi i cili i bën padrejtësi shpirtit të vet dhe (ii) i bën padrejtësi të tjerëve. Të dyja këto kanë qenë ndaluar nga Allahu, i Cili është i pastër nga të metat. Pra, individi i cili i bën padrejtësi shpirtit të vet e ndjen veten të lirë ndaj mëkateve dhe i bën ato, dhe kjo bëhet shkak që ai t'i lë aktet e nënshtimit ndaj Allahut.

Muslimani i vërtetë është larg nga të gjitha këto dhe përveç kësaj:

- Ai nuk është bartës i thënieve keqdashëse -

Prej Enes ibn Malikut (radiallahu 'anhun) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"A e dini se ç'është thashetheme (shpifje) (el-'Adh)? Ata thanë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri." Ai tha: "Bartja e fjalëve të disa njerëzve të disa të tjerë me qëllim të bërjes së çrregullimeve në mes tyre."(46)

Bartja e thënieve është një sëmundje e ndytë; kur ajo hyn në zemër e prish atë, dhe kur zemra priset, priset edhe pjesa tjetër e trupit dhe veprat e njeriut shkatërrohen.

Sëmundja e bartjes së fjalëve gjen vend vetëm në zemrat që janë të mbushura me dashuri ndaj kësaj bote, në zemrat e atyre të cilët e shfrytëzojnë fenë për përfundime të ulëta dhe të neveritura; Kërkojmë ndihmën e Allahut nga kjo!

Sidoqoftë, sa i përket muslimanit të sinqertë, i cili përpiket ta ndjek dhe ta zbatojë udhëzimin e dërguar prej Zotit të tij, atëherë:

- Ai nuk është i përkushtuar ndaj kësaj bote -

Prej Sehl ibn A'dit (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Më erdhi Xhibrili e më tha: "O Muhamed! Jeto si të duash se me siguri do të vdesësh; duaje kë të duash se me siguri do ta lësh atë; vepro si të duash meqë me siguri do të shpërblehesh me shpërblimin që të takon për të. Dije se shkëlqesia e besimtarit është qëndrimi i tij në namaz gjatë natës, dhe nderi i tij është në të pasurit e mjaftueshëm pa qenë i varur prej njerëzve."(47)

Individi i cili jeton duke qenë i preokupuar me këtë botë, është i varfër në lidhje me fenë dhe intelektin e tij. Ai nuk e kupton se kjo botë, për atë që nuk ka fe është rrugë drejt degradimit, rrugë drejt çoroditjes dhe çelës për veprat e këqija e të ndyta. Derisa muslimani i cili është i sinqertë ndaj Zotit të tij dhe shpirtit të vet, ai me vëllezërit e tij duhet të jetë një shembull i shkëlqyeshëm për ata të cilët janë të etshëm për këtë botë dhe disa dirhem e dinarë.

Ai duhet të jetë një mësim për ta se nuk ka të mirë në atë, dhe se e mira qëndron vetëm në marrjen e kësaj bote si një mjet për shtimin e gradave në lidhje me fenë dhe në

kërkimin për pastrimin e Zemrës së njeriut. Sidoqoftë, këto të dyja nuk do të arrihen përveç përmes:

- Distancimi nga kjo botë -

Prej Ebu Uname Ijas ibn Tha'lebes i cili tha:

"Sahabët (shoqëruesit) e të Dërguarit të Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) e përmendën një ditë këtë botë në praninë e tij, kështu që i Dërguari i Allahut tha: "A s'do të dëgjoni, a s'do të dëgjoni! Veshja e teshave të vjetra është pjesë e imanit, veshja e teshave të vjetra është pjesë e imanit!"(48)

Zuhdi (abstenimi) është që të kesh pak konsideratë për këtë botë, të shfaqet varfëria dhe nevoja e njeriut para Allahut, të trajtohen robërit e Allahut më butësi dhe kujdes, shmangia nga shpenzimet e tepruara në tesha, ushqim dhe pije, dhe t'i iket famës.

Zuhd nuk është refuzimi i favorizimeve të Allahut - dhurimeve ndaj disa robërve të Tij, por më saktë, është siç ka thënë shejhul-Islam Ibn Tejmije, rahimehullah: "Largohu nga ajo që nuk sjell dobi, ose nga që ajo nuk përmban fare dobi, ose diçka tjetër përveç saj është më e dobishme, kështu që duke bërë të parën, ai do të humbasë dobi më të madhe, ose do të prodhojë diçka, dëmi i të cilit do ta mbipeshojë dobinë e tij. Por, sa u përket gjërave të cilat janë në pjesën më të madhe apo të tëra të dobishme, atëherë shmangia prej tyre është marrëzi."(49) Andaj, s'duhet të ketë abstenime në

lidhje me:

- Veprat e mira -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Lëmosha (sadaka) i takon çdo nyjës së njeriut për çdo ditë në të cilën lind dielli. Kontributi në ndarjen e drejtësisë në mes dy vetave është lëmoshë; fjala e mirë është lëmoshë; dhe çdo hap që e bëni për t'u falur është lëmoshë."(50)

Pra, nëse robi ka mundësi që t'i kalojë të gjitha ditët dhe netët e tija në nënshtrim ndaj Allahut, dhe në bërjen e veprave që janë të dëshiruara për Të, atëherë le të veprojë kështu!

Edhe pse abstenimit duhet t'i jepet vëmendje e posaçme nga ata që kanë shumë, për shkak të mundësisë së tyre që të shpenzojnë dhe pasurisë së tyre, çka s'është rasti me të varfrit, kjo s'do ta parandalojë muslimanin, të pasur a të varfër, që të ketë një shpirt të pasur dhe të kënaqur, meqë:

- Muslimani është i kënaqur -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Pasuria s'do të thotë të kesh shumë gjëra personale, por pasuri është pasuria e shpirtit (të qenit i kënaqur)."(51)

Pra, pasuria më e madhe që mund ta arrihet, O rob i Allahut, është kënaqësia e shpirtit dhe të pasurit e një zemre të kënaqur, e kjo nuk do të arrihet përveç përmes të qenit i përvuajtur para Allahut, i Cili është i pastër nga çdo e metë, dhe të bërit lutje Atij dhe në të mbështeturit Atij. Pra, ai, shpirti i të cilit është i kënaqur dhe i pasur do ta shtojë:

- Devotshmërinë në fenë Islame -

Prej Ka'b ibn Malik el-Ensarit (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Dy ujqër të uritur që lëshohen në mesin e deleve, s'do t'u bëjnë më shumë dëm atyre sesa që i bën dëm fesë së vet dëshira e individit i cili dëshiron pasuri dhe pozitë."(52,53)

Pra ikni, Allahu ju mëshiroftë, nga kjo dëshirë e çmendur pas kësaj bote dhe stolive të saja, dhe se nuk ka shpëtim nga ajo çka është paracaktuar për një individ.

Pra, ai që e dëshiron shpëtimin, atëherë le të jetë rasti që dëshira e tij për fe të jetë baza e tij dhe parimet udhëzuese, dhe nëse kjo është kështu, atëherë Allahu do ta mbrojë atë dhe fenë e tij. Prej gjërave përfshirëse që duhet të dihen është se

- Si ballafaqohet muslimani me njerëz -

Prej A'ishes (radiallahu 'anha) e cila tha se një njeri kërkoi leje të hyjë te Pejgamberi (sallallahu 'alejhi ue selam), e ai tha:

"Lere le të hyjë, sa bir i keq i popullit të tij (apo: sa njeri i keq i popullit të tij)." Dhe pasi hyri, ai u soll mirë me të. A'isha tha: "O i Dërguar i Allahut, ti the për të atë që the, pastaj i fole fjalë të mira atij?" Ai tha: "Oj A'ishe, njerëzit më të këqij në vendin para Allahut në Ditën e Ringjalljes janë ata, prej të cilëve njerëzit ikin, apo i lënë, më qëllim që ta shpëtojnë veten prej të folurit e tyre të keq."(54) Po ashtu nuk është për t'u fshehur se një prej mënyrave më të mira për forcimin e lidhjeve dhe përmirësimin e marrëdhënieve është:

- Vizita vëllait -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Një njeri doli që ta vizitojë vëllain e tij në një fshat tjetër, kështu që Allahu i Lartësuar e vendojë një engjëll për të në rrugë. Kur engjëlli i erdhi atij, i tha: "Ku je duke shkuar?" Ai tha: "Po shkoj ta vizitoj një vëlla në këtë fshat." Ai tha: "A po shkon te ai për atë se të ka borxh diçka?" Ai tha: "Jo, por e dua atë për hir të Allahut." Ai tha: "Atëherë unë jam dërguar nga Allahu te ti (që të informoj) se Allahu i Madhërishëm të do ty mu ashtu siç ke dashur ti për hir të Tij."(55)

(Parajsa) nuk mund të arrihet nëse nxitje për të nuk është:

- Karakteri i muslimanit -

Prej Ebu Derdas (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Nuk ka gjë që rëndon më shumë në peshojë sesa karakteri i mirë."(56)

Pra, muslimani me karakterin e tij, armiqtë e tij i kthen në shokë, kundërshtarët në shoqërues, dhe njerëzit e ashpër në ata që janë të butë. Karakteri është një komoditet, i cili është diçka e rrallë në mesin e njerëzve sot, përveç në mesin e atyre të cilët sinqerisht e adhurojnë vetëm Allahun, të cilët janë të ndershëm dhe të vërtetë në adhurimin e Zotit të Botëve. Pra, karakteri i mirë e rafinon shpirtin dhe mundëson që:

- Muslimani e di vlerën e vet -

Prej Ebu Hurejres (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut (sallallahu 'alejhi ue selam) ka thënë:

"Do t'ju vij në njerëzve vite të mashtimit në të cilat gënjeshtarit do t'i besohet, i sinqerti do të përgënjeshtrohet, tradhtarit do t'i besohet ndërsa besniku do të konsiderohet

tradhtar, dhe të neveritshmit (er-Ruvejbide) do të flasin. U tha: "Kush janë të neveritshmit?" Ai tha: "Të ulëtit. Njeriu i poshtër i cili flet për çështjet publike."(57,58)

Pra, është e detyrueshme për robin e bindur që:

- Ai shpreson për të mirën e vetvetes dhe vëllait të tij -

Prej Xhundubit (radiallahu ‘anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut ka treguar:

“Se një njeri ka thënë: "Pasha Allahun, Allahu s’do ta falë filanin." Derisa Allahu i Madhërishëm tha: "Kush është ai që betohet në mua se Unë s’do ta fali filanin. Unë e kam falur filanin dhe i kam bërë veprat tua të pavlefshme." (59, 60, 61, 62)

Frika dhe shpresa që Muslimani ka për vëllanë e tij nuk e parandalon atë që të zbatojë atë çka Allahu ka vendosur në lidhje me:

- Urdhërimin në të mirë dhe ndalimit nga e keqja -

Prej Ebu Se’id el-Hudriut (radiallahu ‘anhu) i cili tha:

"I Dërguari i Allahut (sallallahu ‘alejhi ue selam) qëndroi në

mesin tonë që të na mbajë një fjalim, dhe prej fjalimit të tij që ajo se tha: "Vërtet, gati sa s'ka ndodhur që unë do të thirrem dhe të përgjigjem. Pas meje do të pasojnë sundues mbi ju, të cilët thonë atë të cilën e dinë, dhe do të veprojnë sipas asaj çka dinë. Bindja ndaj tyre është bindje ndaj meje, dhe do të mbeteni të tillë për një kohë. Pastaj do të pasojnë sundues mbi ju pas tyre, të cilët flasin atë për çka s'kanë njohuri dhe do të veprojnë sipas asaj për çka s'kanë njohuri. Kushdo që është i sinqertë ndaj tyre dhe i ndihmon apo i forcon ata, atëherë ata janë të shkatërruar dhe kanë bërë shkatërrim. Shoqëroni ata me trupat e juaj ndërsa dallohuni prej tyre me veprat tuaja, dhe dëshmoni për bamirësit prej tyre se është bërës i së mirës, dhe për keqbërësin se është bërës i së keqes."(63,64)

Në urdhërimin e të mirës dhe ndalimin nga e keqja, muslimani është syçelë në:

- Të qenit i kujdesshëm që t'i shmanget armiqësisë dhe përçarjes -

Prej Xhabir ibn 'Abdullahut (radiallahu 'anhu) i cili tha se i Dërguari i Allahut ka thënë:

"Vërtet, Shejtani ka humbur shpresën se ata që falin namaz në gadishullin Arabik do ta adhurojnë atë. Mirëpo, ai mundohet që të provokojë armiqësi ndërmjet tyre."(65)

Kështu që ndoshta një fjalë të cilën njeriu nuk e kupton, lejon që t'i ikë nga gjuha e tij dhe të bie mbi njërin prej robërve të Allahut, apo gabimin që ai e bën ndoshta do të shkaktojë flakërimin e një zjarri të madh në zemrat e vëllezërve.

Këtë Shejtani e dëshiron më së shumti dhe kjo e bën atë të gëzuar dhe të lumtur. Pra, këtë çka treguam, sigurisht ndodh dhe është gati që të ndodhë, dhe kjo çon në përhapjen e së keqes dhe rrezikut të madh. Pra, meqë ky është rasti, atëherë cilat janë:

- Mënyrat për t'u ikur sprovave të cilat i godasin njerëzit -

Prej 'Abdullah Ibn Mes'udit (radiallahu 'anhu) i cili tha:

"Si do të jetë gjendja juaj kur kur t'ju mbulojë një provë në të cilën i riu rritet (piqet) e i vjetri bëhet i pafuqishëm. Nëse diçka nga ajo lihet, do të thuhet: "Është lënë Suneti." U tha: "Kur do të ndodhë kjo, O Ebu 'Abdurrahman?" Ai tha: "Kur dijetarët tuaj të vdesin, dhe injorantët nga mesi juaj të bëhen shumë; kur ata që këndojnë (Ku'ranin) nga mesi juaj të jenë të shumtë, por ata të cilët e kuptojnë fenë të jenë të paktë; kur udhëheqësit e juaj janë të paktë; kur të mirat e kësaj bote kërkojnë me vepra të Botës Tjetër; dhe kur dituria të mësohet për tjetër përveç për fe."(66)

Pra, mënyra për të ikur është shembulli që parapriu për ne! Vërtet, pasimi dhe dëgjueshmëria ndaj të Dërguarit të Allahut (sallallahu ‘alejhi ue selam) është ikja më e madhe nga sprovat të cilat na kaplojnë.

Pra, për Allahun, për Allahun, O robër të Allahut, mësoni dhe veproni, dhe kini frikë Allahun dhe bindjuni Atij që të mëshiroheni.

Epilog

Personaliteti Islamik është një personalitet i dëlirë dhe i dalluar. Pëlhura e tij është Libri i Allahut, ndërsa peri i tij është Suneti dhe këto të dyja janë të pandara nga ai.

Është një personalitet i singertë dhe i vendosur, i edukuar dhe i rafinuar mbi metodologjinë precize e cila nuk përmban madje edhe mangësitë më të vogla, e si mund të ndodhë kjo meqë kjo është fe e Allahut, Zotit të Botëve?!

Ajo çka kam shkruar është dituri e cila është rrugë për në vepër, një përkujtues i cili e çon njeriun në bindje dhe pasim, si dhe këshillë për arritjen e dobisë.

Kështu që e lus Allahun të më japë sukses mua dhe të gjitha muslimanëve, dhe që Ai të na vendosë në rrugën dhe metodologjinë e Pejgamberit të Tij (sallallahu ‘alejhi ue selam). Ai është më i denji që të lutet dhe më i madhi i Cili përgjigjet, dhe thirrja jonë e fundit është, i gjithë lavdërimi i

takon Allahut, Zotit të Botëve.

18 Ramadan, 1408H. ez-Zerka, Jordan.

Fundota:

1. Janë disa hadithe të transmetuara në lidhje me epërsinë e përmbledhjes së dyzet haditheve, mirëpo asnjë prej tyre s'është autentik, siç kam sqaruar në prezantimin tim të dyzet hadithe mbi thirrjen në Islam dhe Thirrësi (E botuar nga el-Hidaje, 1994)
2. Është hadithi i njëzet i Dyzet Hadithe mbi Thirrjen në Islam dhe Thirrësi, burimi dhe sqarimi janë të cituara këtu.
3. Xhemere Hutebil 'Areb (2/475) e Ahmed Zekij Sefuet
4. el-Muvedih li Auhamil-Xhem'uet-Tafrik (1/5) e el-Hatib el-Bagdadit
5. Ibn Rexhebi e citon këtë prej tij në Fadl'Ilmus Selef'alel Halef (f. 59 e botimit me verifikimin tim)
6. Kaptina el-Bekare (2):208
7. Transmetuar nga el-Buhari dhe Muslim
8. et-Tekjid (2/6-7) të Ibn Nuktes
9. Transmetuar nga Ahmedi (nr.5114) dhe të tjerët me sened (zinxhir të transmetuesve) hasen (të mirë). Kam folur lidhur me këtë më hollësisht në fusnotat e mia për el-Hikemul Xhedire bil Idha'eh (f. 1-3) të Ibn Rexhebit
10. Transmetuar nga et-Tirmidhi (nr. 1997) dhe të tjerët përmes Suejd ibn 'Amr el-Kelbit: Hamad ibn Selame na kumtoi prej Ejub es-Sehtijenit prej Muhamed ibn Sirinit. Ky sened është Sahi (autentik) nëse do Allahu, nuk përmban ndonjë që i nevojitet shqyrtim përveç për Suejdin dhe ai është i shpallur si i besueshëm nga një grup dijetarësh, dhe ky është mendimi i preferuar i el-Hafidh Ibn Haxherit. Hadithi po ashtu është i shpallur autentik nga një grup dijetarësh siç është el-Hafidh el-Iraki në Tehrixhul Ihja (2/186), el-Munau i në el-Fejd (1/177), ez-Zubejdi në el-Itihef (6/233) dhe të tjerët, dhe është i sqaruar më tutje në Ghajetul Meram (nr. 472) të Shejh Albanit.
11. Kaptina el-Bekare (2): 143
12. Transmetuar nga Ibn Nasr el-Meruezi në Te'zim Kedris Salat

(nr. 639)

13.Kaptina el-Ankebut (29): 69

14.Transmetuar nga Ibn Maxhe (nr. 3688) dhe Ibn Hibani (nr. 549)

15.Transmetuar nga et-Taberani në el-Mu'xhemul Kebir (nr.11,810) zinxhiri i tij i transmetimit është hasen

16.Transmetuar nga el-Buhari dhe Muslim

17.Transmetuar nga el-Buhari dhe Muslim

18.Disa njerëz e citojnë këtë si hadith por kjo nuk ka bazë si e tillë

19.Shiko Fet-hul Beri (1/167)

20.Transmetuar nga el-Buhari

21.Referoju Eseit Dhamul Hased ue Ahlihi të Ibnul Kajimit me fusnotat dhe verifikimin tim

22.Transmetohet nga el-Hakim (4/574), el-Bejheki në Shu'ebul Iman dhe të tjerë dhe zinxhiri i transmetimit është sahi

23.Transmetuar nga el-Buhari

24.Bustanul 'Arifin (f.79) të en-Neueuiut

25.Transmetuar nga el-Buhari dhe Muslim

26.Transmetuar nga el-Buhari dhe Muslim

28.Transmetuar nga el-Buhari në el-Abadul Mufred (nr.239), Ebu Daudi dhe të tjerët. Zinxhiri i tij i transmetimit është hasen

29.Transmetuar nga Muslimi

30.Shiko hadithin (nr.39)

31.Referoju librit tim, el-Munteken dhe Mauridul Aman min Masaxhidish Shejtan dhe Allahu e bëftë të lehtë kompletimin e tij përmes mëshirës së Tij.

32.Kaptina Gafir (40):60

33.Sahi – transmetuar nga Ahmed (4/267, 271, 276) dhe të tjerë

34.Hadithi 40 në Dyzet Hadithe mbi Thirrjen në Islam dhe Thirrësi

35.Transmetuar nga Ahmed (nr. 5385) dhe të tjerë

36.Transmetuar nga et-Tirmidhi (nr. 2318) dhe të tjerë

38.Transmetuar nga Ebu Daudi dhe të tjerët, me zinxhirë hasen të transmetimit

39.Transmetuar nga Ahmed (3/38,55)

- 40.Transmetuar nga et-Tirmidhi (nr. 2685)
- 41.Transmetuar nga et-Tirmidhi në es-Sunen (nr. 1991)
- 42.Transmetuar nga Muslimi
- 43.Transmetuar nga Ahmedi (5/331) dhe të tjerë
- 44.Transmetuar nga el-Buhari
- 45.Transmetuar nga Muslimi
- 46.Transmetuar nga el-Buhari, el-Bejheki dhe të tjerë
- 47.Transmetuar nga el-Hakim (4/324)
- 48.Transmetuar nga Ebu Daud dhe zinxhiri i tij i transmetimit është hasen
- 49.Mexhmu'ul Fetaua (10/615) (10/615)
- 50.Transmetuar nga el-Buhari
- 51.Transmetuar nga Muslim
- 52.Transmetuar nga Ahmedi dhe të tjerë
- 53.Prej sqarimit (sherh) të Ibn Rexhebit të këtij hadithi
- 54.Transmetuar nga el-Buhari (8/50/80)
- 55.Transmetuar nga Muslim (4/446 dhe 448)
- 56.Transmetuar nga Ahmedi (6/446 dhe 448)
- 57.Transmetuar nga Ahmedi, Ibn Maxhe dhe të tjerë, me zinxhir të dobët të transmetimit
- 58.Shejh Bekr Ebu Zejd në et-Te'alem ue Atheruhu 'alel Fikr uel Kitab (f.7)
- 59.Transmetuar nga Muslim
- 60.Sherhul 'Akidetit Ta'hauije (f.379)
- 61.Kaptina el-Isra (17):36
- 62.Sherhul 'Akidetit Tahauije (f.325)
- 63.Transmetuar nga el-Bejheki në ez-Zuhdul Kebir (nr. 191)
- 64.Transmetuar nga Ahmedi dhe të tjerët. Shiko (nr. 22) të 40 Hadithe mbi Thirrjen në Islam dhe Thirrësi
- 65.Muslim
- 66.Transmetuar nga ed-Darimi (1/64), el-Lalika'i (nr.123). el-Hakim (4/514) dhe të tjerë, me zinxhir sahi të transmetimit.